



Universiteti “Nënë Tereza”

Shkup

Zyra për sigurimin e cilësisë

Mësime të shkëlqyera –Karakteristikat e përsosmërisë

Të jesh pjesë e një mësimi të shkëlqyer është inspiruese, edhe pse jo e lehtë për tu identifikuar. Diçka që është e suksesshme për ligjëruesin me njërin grup mund të mos ketë të njëjtin sukses me grupin tjetër. Sidoqoftë, ka një mendim të përbashkët për karakteristikat e të mësuarit dhe mësimit të shkëlqyeshme. Kjo nuk ka të bëjë me atë që të gjithë të japin mësime në mënyrën e njëjtë. Por ka të bëjë me ndihmën që i jepet ligjëruesit për të reflektuar, vlerësuar dhe zhvilluar qasjen e tij në cilësi më të lartë.

Në vijim përfshihen aspekte të praktikës së shkëlqyer që universiteti pret t'i shohë të vendosura nga stafi mësues.

Aftësi prezantuese dhe motivuese

Ligjëruesit shfaqin qëndrim dhe marrëdhënie pozitive me studentët e tyre në orën e mësimit. Ata tregojnë entuziazëm, ndjeshmëri, humor dhe respekt ndaj studentëve të tyre dhe i dëgjojnë me vëmendje. Ata përdorin lëndën dhe inkurajime, dhe përkrahin mësimin e pavarur. Ata menxhojnë orët e tyre të mësimit në mënyrë të drejtë. Mësuesit më të mirë janë frymëzues, e me zhdërvjelltësi bëjnë pasionin e tyre tek studentët.

Njohuritë mbi lëndën

Ligjëruesit shfaqin njohuri të thellë dhe të saktë për lëndën. Ata promovojnë vlerën dhe qëllimin e kësaj njohurie dhe përfshijnë teorinë dhe hulumtimet. Ata shpjegojnë aplikimet praktike të kësaj njohurie.

Planifikimi

Mësimit është e planifikuar mirë dhe ligjëruesit përdorin syllabusin, skemë të detajuar të punës dhe njohuri për studentët e tyre për të planifikuar orën e mësimit (në shtojcën A).

Mbajtja e të dhënave

Ligjëruesit mbajnë të dhëna të sakta dhe të azhurnuara si kërkohet nga universiteti, p.sh. regjistër/listë të pranisë, skema dhe plan të mësimit, të dhëna për progresin dhe vlerësimet. Ligjëruesi gjithashtu ka njohuri mbi kërkesat specifike të çdo studenti, në qoftë se ka nevojë të mbahet në fshehtësi.

Ambienti në klasë

Ligjëruesit sigurohen që ambienti në klasë përkrah te mësuarin dhe është gati para se të fillojë ora e mësimit. Kjo përfshin renditjen e ulëseve, qasje në IT, disponueshmëria dhe gatishmëria e burimeve tjera. Ata gjithashtu sigurohen se qasja për personat me aftësi të kufizuara është adresuar. Ligjëruesit përdorin ekrane, p.sh. informacione teknike relevante, diagrame, postera dhe punët e studentëve për të krijuar ambient të përshtatshëm për mësim.

Fillimi dhe qëllimet e orës

Ora fillon në kohë, çështjet e pjesëmarrjes dhe saktësisë trajtohen me korrektësi. Qëllimet dhe objektivat specifike të orës së mësimit tregohen në ekran dhe ndahen me studentët në fillim të orës.

Përsëritje

Ora fillon me një rishikim aktiv, test inicial, ose me pyetje përsëritëse, të cilat sigurojnë një fillim stimulues dhe mundësi për të përforcuar të kuptuarit e studentit për punët e më hershme dhe të mësuarit.

Llojshmëria e strategjive të mësuarit

Ligjëruesit përdorin një mori të strategjive të mësimit aktive, grupore dhe imagjinatave. Këto mund të përfshijnë gjithë klasën, grupe të vogla, punë dyshe apo individuale, debate dhe prezantime. Ora ka ecuri dhe varietet. Ora fokusohet te studentët, jo tek ligjëruesit – shih Piramidën e të mësuarit (shtojca B).

Të pyeturit

Ligjëruesit përdorin një mori të teknikave të pyetjeve të hapura dhe aktive për të rritur njohuritë dhe përvojën e studentit, kyçjen e tyre në orën e mësimit dhe vlerësimin e asaj që kanë mësuar.

Përdorimi i gjuhës

Ligjëruesit përdorin gjuhë të qartë dhe të pastër për nevojat e studentëve si dhe për kërkesat e kurikulës. Ata përdorin një mori strategjish për tu siguruar se studentët kanë kuptuar termat relevante akademike. Ata përkrahin zhvillimin e shkathtësive letrare, komunikative dhe numerike të studentëve. Ata i korrigjojnë në mënyrë ndihmese studentët.

Diferencimi

Ligjëruesit sigurojnë një sere aktivitete ose burime që do të zgjerojnë dhe sfidojnë studentët më të fortë dhe më të dobët të mësojnë në mënyrë më aktive. Cilësia e lartë, materialet shtese janë në disponim për aktivitet e zgjeruara.

Burimet

Ligjëruesit përdorin një sërë burimesh të cilësisë së lartë për të përkrahur qëllimet e orës dhe qasjen e gjithë studentëve. Kjo mund të përfshijë informata të shkruara ose aktivitete, burime kompjuterike, prezantime, burime që

gjenerojnë nga studentët. Ligjëruesit ofrojnë faqe interneti të dobishme dhe interesante për të ndihmuar studentët gjatë hulumtimit të tyre .

Vlerësimet dhe qëllimet

Ligjëruesit vlerësojnë të kuptuarit dhe të mësuarit e studentëve të tyre gjatë secilit sesion. Ata sigurohen se studentët e tyre i kuptojnë kriteret e vlerësimit dhe gjithashtu vendosen kriteret minimale të performancës së tyre. Ata sigurohen që vlerësimet të jenë valide dhe administrohen në mënyrë të drejtë, dhe çdo notim është i përpiktë. Ata sigurohen se informata kthyesë u jep studentëve udhëzime të qarta se si të përmirësojnë punën e tyre. Ata sigurojnë se vlerësimi në klasë ndihmon informatën kthyesë për progresin individual të studentit.

Përmbledhja dhe të mësuarit/puna e pavarur

Ligjëruesit në mënyrë të vazhdueshme kontrollojnë të mësuarit dhe në mënyrë efektive bëjnë përmbledhjen në fund të orës së mësimit, me një njohje pozitive për progresin apo të arriturat e studentit. Detyrat e shtëpisë, studimet e mëtejshme të pavarura në janë mirë të shpjeguara, duke përfshirë edhe afatet.

Shtojca A
Një orë mësimi e shkëlqyer – shembull

Hyrja

Përshdetje dhe mirëseardhje

përsëritje

qëllimet

**Zhvillimi i
mësimit**

Paraqitja e profesorit

**Aktiviteti I
studentit**

pyetje

përgjigje

Aktivitet e ndryshme

Përfundimi

**Kontrollo
Të mësuarit**

zgjërohu

Shtojca B

Piramida e të mësuarit

Piramida e të mësuarit nivelizon metodat e mësimit në bazë të %, kalueshmëria e të mësuarit gjegjësisht më pak mësohet mbahet mend kur studenti është vetëm në klasë ndërsa më shumë mësohet studentët ftohen të shpjegojnë ose demonstrojnë një njësi të re.

PIRAMIDA E MËSIMIT

